



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI

Nr. 1156/5 Prot.

Tiranë, më 30/04/2017

V E N D I M

Nr. 50, Datë 30/04/2017

PËR
EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË USHTRUAR NË
KONTROLLIN E LARTË TË SHTETIT
“MBI ZBATIMIN E LIGJSHMËRISË DHE RREGULLSHMËRISË SË
AKTIVITETIT EKONOMIKO FINANCIAR DHE VLERËSIMIN E
FUNKSIONEVE TË SISTEMEVE TË MENAXHIMIT FINANCIAR”

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Drejtorisë së Auditit të Brendshëm, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Drejtorisë së Auditit të Brendshëm, si dhe nga kontrolli i cilësisë pas procedurës së ndjekur për rishikimin për cilësinë e auditimit, mbi vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit në mbështetje të nenit 10 dhe 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit: “Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë të aktivitetit ekonomik dhe financiar dhe vlerësimit të sistemeve të menaxhimit financiar”.

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon

A. MASAT ORGANIZATIVE

Gjetje 1: Në të gjitha procedurat e blerjeve me vlera të vogla si dhe në tenderët, në dokumentacionin përkatës mungon Formulari i Deklarimit të Konfliktit të Interesave të anëtarëve të Njesisë për testimin e tregut dhe përcaktimin e fondit limit si dhe anëtarëve të Komisionit të Prokurimit me vlera të vogla në kundërshtim me nenin 56, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nenit 4 të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” si dhe Kreu IV-Parandalimi i Konfliktit të Interesave të interesave të Pjesës së Pestë, të Rregullores së Brendshme mbi Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 85, datë 30.06.2015

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të gjithë punonjësit që marrin pjesë në procedurat e blerjeve me vlera të vogla dhe tenderët si: anëtarët e Njesisë për testimin e tregut dhe përcaktimin e fondit limit; anëtarët e Komisionit të Prokurimit me vlera të vogla, anëtarët e Njesisë së Prokurimit si dhe anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, duhet të hartojnë Formularin e Deklarimit të Konfliktit të Interesave, e cila do të jetë pjesë e dosjes.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Gjetje 2: Në tenderin e zhvilluar me objekt: “Botim libra për KLSH-në për vitin 2016”, me procedurë: “Kërkesë për propozim”, me procedurë elektronike, rezultoi: Procesverbal i mbledhjes së Njesisë së Prokurimit me nr. 3, datë 18.02.2016 me të cilin është vendosur:

- i. Të miratohen dokumentet e procedurës së tenderit “Kërkesë për propozim”, me objekt: “Botim libra për KLSH-në”.
- ii. Të autorizojë z. N B të nisë procedurën elektronike të prokurimit.
- iii. Të autorizojë z. N B që të përzgjedhë pesë ofertues nga lista e publikuar në faqen e APP-së, për të paraqitur oferta dhe ta miratojë këtë listë, të përbërë nga OE: D; O; P; M dhe T.

Për sa më sipër nxjerrim këto konkluzione:

Procesverbali i mësipërm nën pika (iii) është mbajtur në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, për arsye se NJP nuk ka të drejtë ligjore të delegojë kompetencën ligjore që i ka ngarkuar ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për rregullat e prokurimit publik”, ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” si dhe veprimi i mësipërm bie në kundërshtim dhe me nenin 28-Delegimi i kompetencave të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Në tenderët kërkesë për propozim, të gjitha veprimet e kryerjes së procedurës së tenderit do të kryhen anëtarët e Njesisë së Prokurimit dhe në sanjë rast të mos delegohet kryerja e veprimeve një anëtar.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Gjetje 3: Në tenderin e zhvilluar me objekt: “Botim libra për KLSH-në për vitin 2016”, me procedurë: “Kërkesë për propozim”, me procedurë elektronike, rezultoi:

Në dosje *mungon procesverbali i përzgjedhjes së OE që ftohen për të marrë pjesë*, veprim ky në kundërshtim me:

1. Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 34, pika 1 e cila përcakton shprehimisht:
“Autoriteti kontraktor mund të përdorë procedurën kërkesë për propozim për kontrata me vlerë nën kufirin e ulët monetar. Në bazë të kësaj procedure, autoriteti kontraktor kërkon oferta nga një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë të zgjedhur prej tij, ose mund të përdorë komunikimin elektronik të parashikuar në nenin 36 të këtij ligji. Për këtë përzgjedhje kërkohen të ftohen të paktën 5 operatorë ekonomikë, përveç rasteve kur kjo është e pamundur, për arsye teknike ose për mungesë të konkurrencës. Kjo procedurë nuk duhet të përdoret për të shmangur procedurat konkurruese të prokurimit.
2. VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për rregullat e prokurimit publik”, nenin 39-Kërkesa për propozime, pika 4, e cila përcakton shprehimisht:
“Pavarësisht nga publikimi i njoftimit të kontratës, sipas pikës 2 të këtij neni, autoriteti kontraktor fton për të marrë pjesë dhe të paktën 5 (pesë) operatorë ekonomikë”.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përzgjedhjen e operatorëve ekonomikë që do të ftojë.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Në rastet e kryerjes së tenderëve me procedurë “Kërkesë për propozim”, ku Autoriteti Kontraktor fton për të marrë pjesë të paktën 5 (pesë) operatorë ekonomikë, në çdo rast Njësia e Prokurimit duhet të miratojë me procesverbal përzgjedhjen e pesë Operatorëve Ekonomikë që do të ftohen për të marrë pjesë në tender, duke dhënë dhe argumentimin për përzgjedhjen e tyre.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtoria e Auditimit të Brendshëm.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R